

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 60179/25

Nr. i fq. / Br. st. - 1 -

Data: / Datum: 24.11.25

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 152/25 24/11/2025

Bazuar në nenin 6.2 të Ligjit Nr. 08/L-332 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në lidhje me nenin 30.1, 30.5 shkronja “c” të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenin 12 paragrafi 2 shkronja “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më **21 nëntor 2025**, merr këtë:

VENDIM

PËR RITJEN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË NGA TEJKALIMI I PLANIFIKIMIT TË TË HYRAVE VETANAKE PËR VITIN 2025

1. Me këtë vendim bëhet rritja e planifikimit të të hyrave vetanake (fondi 21) nga shuma e planifikuar prej 3,525,467.00 € në 3, 895,024.75 €.
2. Shuma e mjetet financiare të tejkaluara prej 369,557.75 €, të regjistruara në SIMFK më datën 17.11.2025 alokohet në linjat buxhetore si në vijim:
 - 2.1. Mallra dhe Shërbime, blloku kodues 21/644/18184/130/00000/0451, shuma e mjeteve: 330,000.00 € dhe
 - 2.2. Shpenzime komunale, blloku kodues 21/644/18184/132/00000/0451, shuma: 39,557,75 €.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është tabela 4.1, raporti i të hyrave vetanake i datës 17.11.2025 dhe tabelat e të hyrave indirekte.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë e tjera kompetente, komunale.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendi

